

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

REJ

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J93711608Q

NUIS/NIPT

Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2.

Adresa

Tiranë

Albania

1000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0695630032

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

rejshpk99@yahoo.com

E-mail

ADMINISTRATOR Luan Kapri

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/07/04

Data (viti/muaji/dita)

+355682052610

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-73858-06-29-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Bashkia Vlore

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

30000000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Njesite Administrative Pastrim per vitin 2023

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/08/04

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2023/08/04

Numri i njoftimit

CN/47055/06292023

Kodi CPV

19640000-424410000-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

VKM “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar
Dokumentat Standarte të Procedurës së Prokurimit
Ligji “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

Anullimin e procedurës së prokurimit

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Në faqen zyrtare të Agjensisë së Prokurimit Publik është zhvilluar procedura e prokurimit publik “SHËRBIMI I PASTRIMIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE NOVOSELE, QENDER VLORE DHE SHUSHICE PER VITIN 2023” me Autoritet Kontraktor Bashkia Vlorë,. Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi ishte data 30.06.2023. Kjo procedurë prokurimi është rishpallur nga ana e autoritetit kontraktor pas anulimit të procedurës së mëparshme të prokurimit e konkretisht procedurës së prokurimit me ref REF-67721-04-28-2023. Por autoriteti kontraktor pasi e ri shpalli procedurën dhe më pas e anuloi pas ankimit administrativ të paraqitur prej nesh vendosi ta rishpallë sërish por me ndryshimin përse i përket emërtimit të saj dhe vlerës së saj por në thelb është e njëjta procedurë prokurimi.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Sqarojmë se nga ana e autoritetit kontraktor është rishpallur procedura e prokurimit pavarësisht faktit se për procedurën e parë me REF-67721-04-28-2023 rezultoi të jenë paraqitur ankesa administrative, konkretisht rezultoi se është paraqitur ankim administrativ si nga ana e shoqërisë REJ shpk dhe nga ana e shoqërisë CLEAN FAST shpk Por, pavarësisht këtij fakti, autoritetit kontraktor, pa përfunduar afatet e ankimit e për më tepër kur ka tashmë dijeni zyrtarisht për ankesa administrative, vijon me rishpalljen e procedurës së re të prokurimit.

Në nenin 122 të LPP-së parashikon:

Veprimet paraprake

1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni.5

Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, e publikon në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të paktën të dhëna për:

a) ankuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhënat e plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

4. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit /klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

Ndërsa në nenin 100 të VKM-së Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet:

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/entikontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik?.[]

Përsa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të kishte pezulluar procedurën e prokurimit me nr. REF-67721-04-28-2023 deri në daljen e një vendimi përfundimtar të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesat e paraqitura nga OE, e jo të vijonte mëtej me rishpalljen e procedurës së prokurimit pa patur më parë një vendimarrje përfundimtare nga ana e KPP-së, në një kohë kur duhej që AK të pezullonte veprimet e saj.

Për rrjedhojë sqarojmë se veprimi i autoritetit kontraktor bie ndesh me dispozitat urdhëruese të ligjit dhe aktit nënligjor sa më sipër cituar pasi procedura e parë e prokurimit (ajo me nr. REF-67721-04-28-2023) është e pezulluar dhe nuk mund të vijohet me procedurën e re të shpallur pa patur më parë një vendimarrje nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër kërkojmë anulimin e procedurës së prokurimit me nr ref. REF-73858-06-29-2023.

Përsa më sipër shpjeguar, kërkojmë:

? Anullimin e procedurës së prokurimit .

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

rejshpk99@yahoo.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Luan Kapri